



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:035475

Datë: 28.10.2024

Numri i dokumentit: 06359838

KF.nr.372/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, dhe me zyrtaren ligjore Artta Hyseni, në kontestin tregtar administrativ, të paditësit “L.N.” B.I, me numër unik identifikues 810884074, dhe me seli në Rr. Kuvendi i Bujanit nr.44, Prishtinë, kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimit, objekt kontesti vlerësim tatimor, vlerë kontesti 50,239.73€, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të mbajtur me datë 09.10.2024 në prani të paditësit L.N., dhe në mungesë të të përfaqësuesit të autorizuar të palës së paditur, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit “L.N.” B.I me seli në Prishtinë, si e bazuar.
- II. ANULOHET Vendimi nr.432/2020 i datës 19.01.2021 i Departamentit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë, dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e paraqitur në gjykatë, me datë 24.02.2021 dhe në plotësimin e padisë të datës 27.01.2022 ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurës ATK-së, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave ligjore dhe aplikimi i gabuar i tyre, vërtetimi i gabuar i çështjes faktike dhe mashtrim, me propozimin që të anulohet në tërësi vendimi i ATK-së i datës 19.01.2021 që e ngarkon paditësin me pagesë të detyrimeve tatimore në vlerë totale prej 50,239.73€. Në seancën e shqyrtimit

gjyqësor përfaqësuesi i autorizuar i palës paditëse deklaroi se paditësi ka paraqitur dëshmi që ka bërë kërkesë për mbyllje të biznesit në vitin 2010, provë kjo e cila është e bashkangjitur në shkresat e lëndës dhe i njëjti duke marrë parasysh nenin 12 gjegjësisht paragrafin 5 të Ligjit për ATK, ka kuptuar se meqenëse brenda afatit 60 ditor nuk është bërë ndonjë kërkesë nga e paditura për ndonjë dokument shtesë, dhe meqenëse se i njëjti ka mbyllur edhe llogaritë e biznesit dhe nuk ka pasur asnjë obligim tatimor ky biznes konform kësaj dispozite është konsideruar i mbyllur. Meqenëse disa vite më pas i njëjti ka pasur qëllimin e hapjes të një biznesi tjetër në momentin e ballafaqimit me të paditurën është njoftuar se biznesi i tij figuron aktiv në momentin e paraqitjes së dëshmisë nga ana e paditësit kërkesën për mbylljen e biznesit, zyrtarja e të paditurës zonja N.K. e cila ka qenë përgjegjëse për lëndën i ka thënë paditësit se nuk po mundem me e gjet dosjen duke i propozuar që të bëjë një kërkesë të re për mbyllje të biznesit, me ç'rast e paditura ka hapur kontrollin ndaj paditësit. Paditësi konsideron se biznesi ka qenë i mbyllur dhe e paditura pa të drejtë e ka ndëshkuar me shumën si në padi pasi që i njëjti është person fizik dhe si i tillë nuk ka pasur për obligim mbajtjen e regjistrave si librat tatimor, libri i shitjes, libri i blerjes apo edhe arkë fiskale, ku këtë e parasheh edhe ligji në fuqi. Për më tepër e paditura gjatë kontrollit të saj ka bërë vërtetim të gabuar duke marrë parasysh se të hyrat të cilat paditësi i ka tërhequr nga llogaria bankare e bashkëshortes së tij dhe të njëjtat në po të njëjtën ditë dhe në shumën e njëjtë i ka deponuar në bankomat në të njëjtën bankë, ku realisht meqenëse deponimi është bërë përmes bankomatit në atë kohë nuk ka qenë e mundur që të bëhet përshkrimi. Sa i përket huazimit të mjeteve nga motra e gruas V.M. e cila këtë huazim në shumë prej 100,000.00 dollarë amerikan i ka huazuar paditësit prej firmës të cilën e posedon I.B. si pronare e këtij biznesi, për rregullimin e çështjes së trashëgimisë familjare ku të njëjtën shumë paditësi i ja ka bartur në llogarinë e vëllait të tij A.N. përmes transaksionit bankar. Meqenëse bashkëshortja e paditësit dhe motra e saj kanë qenë trashëgimtare të vetme të një banese në qendrën e Prishtinës dhe gjatë zhvillimit të procedurës së trashëgimisë tek noteri të njëjtën shumë të mjeteve të huazuara e kanë zbatuar në këtë çështje dhe i dorëzon gjykatës aktvendimin mbi trashëgiminë me numër LRP.nr.46/2018. Tutje deklaroi se meqenëse e paditura po ashtu e ka ngarkuar paditësin për shumën prej 3,000.00 euro shumë kjo e cila paditësi i ka huazuar personit me emrin A.G. i cili të njëjtat ia ka kthyer duke ia deponuar në llogarinë bankare dhe për këtë gjykatës i ka bashkangjitur edhe provën ku i njëjti ka deklaruar qëllimin e huazimit të mjeteve dhe kthimit dhe e ka nënshkruar. Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i paditësit deklaroi se pas të gjitha shqyrtimeve të kryera në seancat gjyqësore kanë dalë në pah provat e pakontestueshme mbi mbështetjen e të cilave i propozon gjykatë që ta aprovoj plotësisht padinë e paditësit të parashtruar ndaj vendimit të ATK-së të datës 27.01.2022.

E paditura, në përgjigjen në padi të datës 28.04.2023 deklaroi se konteston në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar. Pretendimi i paditësit se ka bërë kërkesë për mbyllje të biznesit me datë

02.10.2020, nuk është i bazuar sepse me dokumentin “Kërkesë për Vërtetim Tatimor” nuk mund të mbyllët biznesi, pasi që pas pranimit të të njëjtit ai është dashur që të paguaj të gjitha obligimet tatimore, dhe pastaj t’i drejtohet edhe Agjencisë për regjistrimin e Bizneseve në Kosovë dhe pas marrjes së dëshmisë nga kjo e fundit, t’i drejtohet edhe një herë ATK-së, me qëllim që e njëjta t’i mbyll llogaritë tatimore dhe të lëshoj dokumentin përfundimtar për shuarje të biznesit. Tutje deklaron se ATK ka konstatuar se paditësi në vazhdimësi ka pas qarkullim të parasë në llogaritë bankare e për të cilat nuk ka arritur të dëshmoj prejardhjen e tyre, gjë që nga ATK-ja është llogaritur si qarkullim i padeklaruar i paditësit. Sa i përket pretendimit se deponimet janë bërë për kthim të kredisë dhe të cilat kanë burim nga paga e bashkëshortes, e për të njëjtat duke mos paraqitur dëshmi bindëse mbi kronologjinë rrjedhës së parasë, ATK konsideron se nuk qëndron as ky pretendim i paditësit. Ndërsa sa i përket pretendimit për trajtimin e shitjes së pronës me datë 23.10.2014 si e hyrë e biznesit duke e njohur si kosto vetëm vlerën në kohen kur është blerë toka në vitin 2001 dhe jo vlerën që ka pas toka në vitin 2014 kur ka ndodh shitja, ATK konstaton se kontrolli ka vepruar konform nenit 31 të Ligjit 05/L025, përkatësisht paragrafi 1, 2 dhe 5. Lidhur me pretendimin e paditësit se kontrolli ka njohur si shpenzim një dokument të ndërmjetësimit në vlerë prej 8,000.00€, ATK vlerëson se kontrolli ka vepruar konform nenit 23 të UA nr.15/2010, andaj me të drejtë ATK pas analizimit të dokumentit të prezantuar nga paditësi, konstaton se i njëjti nuk i plotëson kriteret ligjore të lartcekura për tu njohur shpenzim. Pretendimi tjetër i paditësit sa i përket aplikimit për ndëshkimin administrativ nga ZGJONA si dhe ndëshkimeve mandatorë, ATK vërteton se si rezultat i gjetjeve të kontrollit për periudhat kontrolluese 2014-2019, ZGjONA ka aplikuar ndëshkimet në vlerë prej 6,236.05€ bazuar në nenin 52 paragrafi 1 dhe nën paragrafi 1.2 të Ligjit nr.03/L-222. Mbështetur në dispozitat ligjore të lartcekura, vërtetimit të gjendjes faktike si dhe interpretimin e drejtë të dëshmi të tjera si në shkresat e lëndës, ATK-ja i propozon gjykatës që pas administrimit të provave dhe analizimit të dispozitëve ligjore, ta refuzoj në tërësi si të pabazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit dhe ta vërtetoj si të drejtë dhe të bazuar në ligj Vendimin e DA të ATK-së me nr.432/2020 datë 19.01.2021. Përmes parashtresës së datës 01.10.2024 e paditura e kundërshton në tërësi ekspertizën financiare dhe plotësimin e ekspertizës dhe kërkon nga gjykata që mos t’ia fal besimin ekspertizës financiare por te fuqizoj vendimin e ATK-së nr.432/2020 datë 19.01.2021.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 09.10.2024 ka administruar provat relevante dhe atë: Vendimi nr.432/2020 datë 19.01.2021, Raporti i kontrollit datë 13.10.2020, Vendimi i ZGJONA nr.1397/2020 datë 15.10.2020, Kontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë datë 17.06.2001, Deklaratë me shkrim e datës 23.10.2014, Gjendja e llogarisë bankare në NLB Bank data e shtypjes 21.11.2019, Qarkullimi për llogari për periudhën 05.05.2014-19.02.2021 në NLB Bank, dhe qarkullimi i shtypur datë 19.02.2021,

09.07.2020, Tabela lidhur me të hyrat nga llogari bankare (private) – arsyetimet për deponimet për vitin 2014, 2015, 2016, 2017, 2018 dhe 2019, Letër dëshmie për Autoritet e ATK-së dt. 22.10.2020, Deklaratë nga H.N. për ATK-në, Deklaratë datë 28.02.2020, Përgjigje në padi e datë 28.04.2023, Caktimi i rasteve për kontroll datë 23.01.2020, Ankesë në DA e datë 20.12.2020, Formë për vizitat përmbushëse datë 19.11.2019, Kërkesë për vërtetim tatimor datë 02.10.2010, Dokument marrëveshje datë 19.04.2018, Transfere bankare datë 04.04.2018, 03.01.2019, Formular për mbylljen e llogarisë në Raiffeisen Bank 04.11.2010, Marrëveshje për hapjen e llogarisë Raiffeisen Bank 29.01.2009, Aktvendim mbi trashëgiminë LRP.nr.46/2018, dhe LRP nr. 2237/2015, Kontratë mbi dhuratën e paluajtshmërisë Tokë nr. 3911/2016 dhe LRP.nr.3538/2017, Kontratë qiraje datë 11.05.2010, Pasqyrat e T/P e datë 28.04.2023, Të dhënat nga ARBK për paditësin, Kursi i dollarit datë 25.01.2018 dhe 19.01.2018 nxjerrja nga EURO System, Kontratë për shitblerjen e paluajtshmërisë LRP.nr.5415/2014 dt 23.10.2014, Ekspertizë financiare e datë 10.06.2024 dhe plotësimi i ekspertizës i datë 03.10.2024, Kundërshtimi i ekspertizës i datës 03.09.2024 dhe kundërshtimi i plotësimit me datë 04.10.2024, Pasqyra e T/P e datë 25.09.2024, Aktvendimi i Komunës së Podujevës datë 15.07.2004.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigje në padi, bëri ballafaqimin e provave të palëve ndërgjyqëse, dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, konstatoi se kërkesëpadija e paditësit është e bazuar, andaj vendosi që lënda të kthehet në rishqyrtim për arsye se:

Nga arsyetimi i vendimit kontestues, thëniet në ankesë, dhe Raporti i Kontrollit i datës 13.10.2020, gjykata konstaton se paditura ka kryer vlerësim tatimor për paditësin bazuar nga informatat nga palët e treta. Objekt i vlerësimit tatimor kanë qenë verifikimi i korrekhtësisë së regjistrimeve dhe deklarimeve të tatimpaguesit që janë objekt kontrolli TM1/2014 deri TM1/2019, Deklarata vjetore PD 2014, 2015, 2016, 2017, 2018, 2019, Kontributet e pronarit CI 01/2014 ftri 12/2014, TVSH për periudhën 10/2014 deri 12/2019. Deri te tatimi shtesë për TVSH, Tatim në të Ardhura Personale, dhe Kontribute Pensionale Individuale, ka ardhur bazuar në informatat nga palët e treta-informatat nga banka, prej nga kontrolli me aplikimin e metodës indirekte të vlerësimit e njohur si Metoda e Deponimeve Bankare dhe Shpenzimeve të Keshit nga neni 30 paragrafi 3.2 të Udhëzimit Administrativ nr.15/2010 për zbatimin e Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, ka vlerësuar se tatimpaguesi ka deponuar para në llogarinë personale dhe të bashkëshortes së tij për periudhën e kontrollit, e të cilat mjete nuk janë deklaruar prandaj me kontroll këto mjete janë trajtuar si qarkullim shtesë për biznesin, këtu paditësin.

Gjykata konstaton se vendimi i kontestuar nuk përmban arsye mbi faktet vendimtare, të vlefshme për zgjidhjen e drejtë të çështjes në shqyrtim. Në fakt, në vendimin e kontestuar nuk janë dhënë arsye të bazuara lidhur me qarkullimin dhe tatimin shtesë me të cilin është ngarkuar paditësi në procedurë të kontrollit. E paditura përveç pretendimit se paditësi ka deponuar mjete financiare në llogari personale dhe të biznesit, nuk ka arritur me asnjë provë ta provoj faktin esencial se paditësi gjatë periudhës për të cilën i është nënshtruar kontrollit ka ushtruar aktivitet ekonomik siç përcaktohet me nenin 1 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat. Për më tepër, gjykata vlerëson se e paditura nuk i ka zbatuar drejtë dispozitat ligjore nga neni 19.2, 19.3 të Ligjit nr.03/L-222, pastaj neni 30 paragrafi 1, 2 dhe 3.2, i UA nr.15/2010 për zbatimin e Ligjit nr.03/L-222, për arsye se sipas këtyre dispozitave ligjore vlerësimi tatimor duhet të kryet sipas gjykimit më të mirë dhe në radhë të parë duhet të kryhet bazuar në aplikimin e metodave direkte të kontrollimit dhe regjistrimeve të tatimpaguesit.

Në nenin 30, paragrafi 3.2, Metoda e Depozitave Bankare dhe Shpenzimeve të Kesh-it, ndër të tjera parashihet që *“MDBShK, mund të përdoret në verifikimin e deklaratave të biznesit dhe atyre që nuk janë të biznesit. Mundet që, furnizimi të çojë në të ardhurat shtesë të pa raportuara, jo vetëm nga shumat dhe shpeshtësia e depozitave, por gjithashtu duke identifikuar burimet e depozitave të tilla. Përcaktimi se sa mjete të depozituara janë shpërndarë apo akumuluar (kujt dhe për çfarë qëllimi) mundet gjithashtu të japë drejtime në burime tjera të të ardhurave. Nëse MDBShK tregon një nën raportim të të ardhurave, mund të jetë për shkak të mos-raportimit të arkëtimeve bruto apo mbi-raportimit të shpenzimeve, apo një kombinim i të dyjave”*. Në kuptim të drejtë të kësaj dispozite ligjore, gjykata vlerëson se nuk është i mjaftueshëm vetëm konstatimi i dhënë i të paditurës në vendimin kontestues dhe raportin e kontrollit se paditësi ka deponuar mjete financiare në llogarinë individuale për periudhën 2014-2019, andaj të njëjtat janë konsideruar si të hyra të pa deklaruar dhe janë marr si qarkullim shtesë, për faktin se sikurse shihet nga dispozita ligjore e cituar nuk mjafton vetëm shuma dhe shpeshtësia e depozitave në llogari bankare por duhet identifikuar edhe burimet e depozitave, çka në fakt nuk rezulton që e paditura e ka bërë. Pra, e paditura as në vendim kontestues por as në raportin e kontrollit nuk ka arritur të argumentoj pretendimin se mjetet e deponuara në llogari personale të pronarit të biznesit-këtu paditësit e kanë burimin nga aktiviteti ekonomik i biznesit dhe si të tilla i nënshtrohet tatimit.

Lidhur me çështjen kontestuese të deponimeve bankare, gjykata konstaton se duke u bazuar në dispozitat ligjore të aplikueshme për periudhën e kontrollit 2014-2019, duke filluar nga Ligji nr.03/L-161 për Tatim në të Ardhura Personale, neni 2 përkufizimet paragrafi 1.11 dhe 1.12, neni 4 i këtij ligji, neni 2 i Udhëzimit Administrativ nr.13/2010, neni 1 përkufizimet paragrafi 1.10 dhe 1.11, neni 4, neni 5, neni 7 i Ligjit nr.05/L-028 për Tatim në të Ardhura Personale dhe neni 10 i UA nr.01/2016, përcaktohet se çka

përfshihet tek të ardhurat bruto, e ku deponimet në bankë në mënyrë taksative, nuk janë përfshirë në kategorinë e të ardhurave bruto që do të përfshiheshin si objekt i tatimit në vështrim të nenit 4 të Ligjit nr.03/L-161 dhe nenit 4 e 7 të Ligjit nr.05/L-028 për Tatim në të Ardhura Personale. Rrjedhimisht, gjykata nga arsyetimi i vendimit kontestues nuk ka mundur të konstatoj se cilat argumente kanë qenë vendimtare si dhe bazën ligjore kur deponimet janë trajtuar si të ardhura nga aktiviteti ekonomik, ku me asnjë provë në shkresat e lëndës nuk argumentohet se paratë e deponuara në bankë e kanë burimin nga aktiviteti ekonomik i biznesit. Prandaj për gjykatën është i pabazuar referimi i të paditurës vetëm në nenin 30 paragrafi 3.2 të Udhëzimit Administrativ 15/2010 për zbatimin e Ligjit nr.03/L-222, për të arsyetuar vlerësimin e kontrollit se deponimet e kanë burimin nga aktiviteti ekonomik i pa deklaruar.

Gjykata për të vërtetuar gjendjen reale në lidhje me vërtetimin e faktit nëse të hyrat në llogaritë bankare të pronarit të biznesit dhe bashkëshortes së tij, janë të hyra nga aktiviteti ekonomik apo të hyra tjera, ka caktuar ekspertizë financiare. Eksperti financiar Sh.B. në ekspertizën financiare të datës 10.06.2024 dhe në plotësimin e saj me datë 03.10.2014, si dhe në seancat e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se të hyrat e konstatuara për periudhën 01.01.2014 deri më 31.12.2019 në pasqyrën e qarkullimit bankar me nr.1708003023002924 janë të hyra nga shitja e tokës, të hyrat nga qiratë, të hyra nga deponimet e bëra nga A.G., të hyra nga deponimi i L.N., të hyra nga deponimi i A.G., të hyra nga deponimi konvertim i USD ne euro prej Invivo Brands (Kompani amerikane në emër të motrës së bashkëshortes së L.N.t). Po ashtu në plotësimin e ekspertizës financiare janë përshkruar në detaje të gjitha deponimet dhe tërheqjet e bëra ndërmjet llogarive të pronarit të biznesit dhe bashkëshortes së tij.

Gjykata ia fali në tërësi besimin ekspertizës financiare dhe plotësimin të saj, për arsye së në të njëjtën janë sqaruar më mënyrë të detajuar të gjitha faktet dhe provat për të vërtetuar gjendjen reale faktike dhe e njëjta i është përmbajtur në tërësi detyra të përcaktuara në aktvendimit KF.nr.372/22 të datës 29.04.2024.

Gjykata ka shqyrtuar vlerësimin e raportit të kontrollit në lidhje me fitimin e llogaritur nga shitja e pronës dhe konsideron se i njëjti vlerësim është në tërësi i pabazuar pasi që nuk ka marr për bazë fakte tjera të rëndësishme siç është inflacioni dhe ndarja e tokës në dy parcela. Konstatimi në raport të kontrollit se paditësi ka pasur fitim vetëm duke u mbështetur në konvertimin e vlerës blerëse nga DM në Euro, për gjykatën është i mangët dhe nuk është i bazuar në fakte tjera reale, e sidomos në fuqinë blerëse të parasë në kohë dhe vlerën e hapur të tregut në kohën e shitjes së pasurisë.

Gjykata konsideron se e paditura duke analizuar rrjedhën e parasë në llogaritë personale të pronarit të paditësit dhe të bashkëshortes së tij, ku deponimet në bankë i ka cilësuar si të hyra nga aktiviteti ekonomik i biznesit pa analizuar burimin e mjeteve, respektivisht faktin se deponimi nga A.G., ka qenë kthim i huazimit, faktin tjetër se deponimi nga Astrit Gashi ka qenë për kompensimin e demit të banesës si dhe deponimi në vlerë prej 100,000.00\$ në llogari të bashkëshortes së paditësit është nga Invivo Brands, firma e motrës e bashkëshortes së paditësit, e cila ka sjell deklaratën se këto mjete i ka transferuar te motra për të rregulluar çështjen e trashëgimisë së pasurisë. Pastaj dedikimin e parasë së njëjtë përmes tërheqjeve, deponimet për shlyerje të kredisë etj., vërteton për vlerësim joreal të gjendjes faktike sepse deponimet dhe tërheqjet nga banka bëhen për mbulimin e shpenzimeve dhe obligimeve të natyrave të ndryshme dhe nuk mund të nënkuptohet vetvetiu se ato janë të hyra nga biznesi, pa i analizuar faktet me rëndësi siç janë në rastin konkret të hyrat nga huazimet, kompensimi i demit, të hyrat nga qiraja dhe transferi nga Amerika. Në asnjë rast e paditura nuk ka arritur të konstatoj fakte se paditësi ka realizuar transaksione biznesi me ndonjë biznes tjetër, apo ka pranuar apo lëshuar fatura tatimore me ndonjë biznes.

Duke marrë parasysh konstatimet e lartcekura, gjykata nuk mund të pajtohet me një qëndrim të tillë juridik të paditurës të dhënë në vendimin kontestues, për shkak se vendimi kontestues përmban të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, të metat e tilla konsistojnë në faktin se arsyetimi i vendimit kontestuese përmban të dhëna të pamjaftueshme dhe jo të plota sa i përket qarkullimit dhe tatimit shtesë i cili ka rezultuar me kontroll nga deponimet e pronarit të paditësit në llogaritë bankare individuale.

Gjykata e obligon të paditurën në ri procedurë dhe rivendosje që t'i analizoj edhe njëherë deponimet e bëra nga pronari i këtu paditësit në llogarit bankare individuale, të analizoj mundësitë financiare-të hyrat të cilat i njëjti i ka pranuar nga qiraja dhe kthimet e huazimeve, të analizohet edhe llogaria bankare e bashkëshortes së paditësit respektivisht të hyrat të cilat e njëjta i ka pranuar nga motra e saj, të shqyrtohet deklarata e datës 25.09.2024, e motrës së bashkëshortes së pronarit të biznesit- paditësit. E paditura në riprocedurë të shqyrtoj dosjen e tatimpaguesit në ATK lidhur me kërkesat e tij për mbyllje të biznesit me datë 01.10.2010, përkatësisht të shqyrtoj faktin se paditësit i është lëshuar vërtetim tatimor në bazë të kërkesës së datës 01.10.2010 me qëllimin e shuarjes së biznesit, të merret parasysh edhe fakti se paditësi llogarinë e biznesit e ka mbyllur me datën 04.11.2020, e që e njëjta është kusht elementar për posedimin e certifikatës së numrit fiskal. Krejt në fund të hyrat të krahasohen me deponimet e bëra në bankë dhe mbi këto bazë të nxirret konstatimi nëse ka të hyra të cilat nuk janë raportuar nga paditësi e të cilat e kanë burimin nga aktiviteti ekonomik i paditësit. E paditura në rivendosje duhet të deklarohet

nëse paditësi gjatë periudhës e cila ka qenë objekt i vlerësimit tatimor, ka pasur vizita tatimore inspektuese, nëse ka pasur cila ka qenë gjendja e konstatuar respektivisht a ka ushtruar aktivitet ekonomik ose jo paditësi.

Si përfundim, gjykata konkludon se në këtë konflikt administrativ ekzistojnë të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar. Në këtë drejtim, gjykata bazuar në autorizimet nga neni 81.I paragrafi 2 pika 2.2 të Ligjit 04/L-102 dhe nenit 43 par.2 të LKA-së, e detyron organin e paditur Departamenti i Ankesave i ATK-së, që në ri procedurë të veprj sipas vërejtjeve të dhëna në arsyetim të këtij aktgjykimi, duke pasur parasysh se nuk janë vlerësuar në mënyrë të drejt të gjitha faktet që kishin me ndikuar në vendosjen e drejt të çështjes. Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Vendimin që secila palë ti bartë shpenzimet e procedurës, Gjkata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga sa u tha më lart, Gjkata konform dispozitave 43, par 2 dhe nenit 46, par 1 dhe 2, të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.372/22 datë 09.10.2024

Gjyqtarja

Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.